



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 85, paragrafi 1, dhe nenit 114 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, në lidhje me nenet 44 dhe 94, të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më datë 29 tetor 2018, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR FAKTORINGUN**

### **KAPITULLI I**

#### **Dispozitat e Përgjithshme**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi dhe Fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kriteret e përgjithshme rregullative për ushtrimin e veprimtarisë financiare të faktoringut nga subjektet që licencohen/regjistrohen nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për të ushtruar këtë veprimtari.
2. Kjo Rregullore përkufizon dhe rregullon veprimtarinë financiare të faktoringut, llojet e faktoringut, kontratën e faktoringut, të drejtat dhe detyrimet e palëve në transaksionin e faktoringut, si dhe raportimin dhe mbikëqyrjen e subjekteve të licencuara/regjistruara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për të ushtruar këtë veprimtari.
3. Kjo Rregullore zbatohet ndaj subjekteve të licencuara/regjistruara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për të ushtruar veprimtarinë e faktoringut.
4. Kjo Rregullore nuk zbatohet për cedimin e rregullt të kërkesave të arkëtueshme që ushtrohet nga subjektet që nuk janë institucione financiare dhe nuk ofrojnë shërbime të faktoringut si aktivitet të rregullt të biznesit të tyre për fitim, në pajtim me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

##### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

1. Termat që përdoren në këtë Rregullore e kanë kuptimin që u është dhënë atyre për qëllimin e kësaj Rregulloreje, si më poshtë:

- 1.1. Faktoringu** është veprimtari financiare e lejuar me të cilën faktori blen dhe/apo pranon kërkesa të arkëtueshme ekzistuese të pamaturuara apo kërkesa të arkëtueshme të ardhme afatshkurtra deri në një (1) vit, të cilat rrjedhin nga kontrata bazë e shitblerjes së mallrave apo shërbimeve nga furnizuesi në atë kontratë bazë. Një transaksion i faktoringut mund të bazohet në një shitje/blerje të kërkesave të arkëtueshme apo në një transferim të thjeshtë të kërkesave të arkëtueshme. Një transaksion i faktoringut do të konsiderohet të jetë një blerje dhe/apo cedim (pranim) i kërkesave të arkëtueshme, përveç nëse kontrata përcakton në mënyrë specifike se transaksioni lidhet vetëm me një transferim specifik të kërkesave të arkëtueshme.
- 1.2. Pjesëmarrësit në faktoring janë** faktori, furnizuesi dhe blerësi.
- 1.3. Faktori** është subjekti juridik, i licencuar/regjistruar për faktoring nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, i cili në bazë të kontratës së faktoringut, blen dhe/apo pranon objektin e faktoringut nga furnizuesi.
- 1.4. Furnizuesi** është subjekt juridik apo person fizik, i regjistruar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare për ushtrimin e aktiviteteve të biznesit, duke shitur dhe/apo transferuar objektin e faktoringut tek faktori.
- 1.5. Blerësi** është subjekt juridik apo person fizik (përfshijë konsumatorin), i regjistruar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare për ushtrimin e aktiviteteve të biznesit, i cili është debitor i objektit të faktoringut ndaj furnizuesit.

### **Neni 3**

#### **Veprimtaria Financiare e Faktoringut**

1. Faktoringu, si veprimtari financiare, mund të ushtrohet vetëm nga subjektet juridike që licencohen/regjistrohen nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për të ushtruar veprimtarinë e faktoringut.
2. Subjektet juridike të licencuara/regjistruara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mund të ushtrojnë veprimtarinë e faktoringut vetëm në bazë të kontratës, të lidhur me shkrim, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë Rregullore.

## **KAPITULLI II**

### **Llojet e Faktoringut**

#### **Neni 4**

#### **Baza për Kategorizimin e Faktoringut**

1. Transaksionet e faktoringut kategorizohen në bazë të origjinës së palëve në kontratën e faktoringut, objektit të faktoringut, si dhe rreziqeve në lidhje me mbledhjen e kërkesave të arkëtueshme që merren përsipër nga palët në faktoring.

2. Llojet e përgjithshme të faktoringut janë si në vijim:
  - 2.1 faktoringu vendor;
  - 2.2 faktoringu i huaj;
  - 2.3 faktoringu me mjet (garanci); dhe
  - 2.4 faktoringu pa mjet (garanci).
3. Lloj i posaçëm i faktoringut është faktoringu i anasjelltë.
4. Lloji i faktoringut duhet të përcaktohet qartë në kontratën e faktoringut.

### **Neni 5**

#### **Faktoringu Vendor**

Faktoringu vendor është transaksion objekti i të cilit është shitja dhe/apo transferimi i kërkesave të arkëtueshme që rrjedhin nga shitja e mallrave apo ofrimi i shërbimeve ndërmjet subjekteve të regjistruara dhe që ligjërisht ekzistojnë në Kosovë dhe/apo personave fizikë me banim në Kosovë dhe janë të regjistruar për ushtrimin e aktiviteteve të biznesit.

### **Neni 6**

#### **Faktoringu i Huaj**

1. Faktoringu i huaj është transaksion objekti i të cilit është shitja dhe/apo transferimi i kërkesave të arkëtueshme që rrjedhin nga shitja e mallrave apo ofrimi i shërbimeve ndërmjet subjekteve juridike dhe/apo personave fizikë, një prej të cilëve nuk ka seli/banim në Kosovë.
2. Nëse faktoringu i huaj përfshin më shumë se një faktor, faktori me seli/banim në Kosovë obligohet të lidhë marrëveshje mes faktorëve, e cila rregullon marrëdhënien ndërmjet faktorit vendor dhe faktorit të huaj dhe që duhet të jetë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
3. Në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi, në rastin e faktoringut të huaj, kontrata e faktoringut do të qeveriset dhe interpretohet në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore, bashkë me ligjet në fuqi të Kosovës, të cilat zbatohen ndaj faktoringut si veprimtari financiare, do të vlejnjë për faktoringun e huaj edhe në rastet kur kontrata e faktoringut dhe/apo kontrata bazë që është objekt i kontratës së faktoringut rregullohet me ligje të ndonjë vendi tjetër.

### **Neni 7**

#### **Faktoringu me Mjet (Garanci)**

1. Faktoringu me mjet (garanci) është transaksion në të cilin furnizuesi merr përsipër rreziqet e mbledhjes së kërkesave të arkëtueshme, të cilat faktori i mbledh nga blerësi, duke përfshirë por pa u kufizuar në rreziqet që ndërlidhen me paaftësinë e pagesës (insolvencën) së blerësit.

2. Tek faktoringu me mjet (garanci), furnizuesi i garanton faktorit ekzistencën, vlefshmërinë dhe mbledhjen e kërkesave të arkëtueshme.
3. Tek faktoringu me mjet (garanci), furnizuesi dhe blerësi janë përgjegjës ndaj faktorit për pagesën/mbledhjen e kërkesave të arkëtueshme në pajtim me kushtet dhe afatet e përcaktuara me këtë Rregullore.
4. Përveç nëse ndryshe është përcaktuar në kontratën e faktoringut, tek faktoringu me mjet (garanci), faktori së pari kërkon pagesën e kërkesave të arkëtueshme nga blerësi. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe me kontratë, vetëm nëse blerësi dështon të paguajë kërkesat e arkëtueshme brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga data kur kërkesat e tilla të arkëtueshme bëhen të pagueshme, faktori ka të drejtë të kërkojë pagesën e kërkesave të arkëtueshme nga furnizuesi dhe/apo të dy, furnizuesi dhe blerësi. Pasi që faktori të ketë pranuar pagesën e kërkesave të arkëtueshme nga cilido prej furnizuesit ose blerësit, apo nga të dy, në shumta përkatëse, detyrimi i furnizuesit dhe/ose blerësit për pagesë të kërkesave të arkëtueshme ndaj faktorit konsiderohet i përmbushur.
5. Përveç nëse kontrata e faktoringut emërohet si kontratë e faktoringut me mjet (garanci), kontrata e faktoringut konsiderohet të jetë kontratë faktoringu pa mjet (garanci).
6. Për të shmangur dyshimin, mjeti që faktori ka ndaj furnizuesit për mbledhjen e kërkesave të arkëtueshme nuk ka ndikim ligjor apo tjetër mbi vlefshmërinë e shitjes dhe/apo transferimit të kërkesave të arkëtueshme nga furnizuesi tek faktori. Në fakt, dhe përveç nëse parashihet ndryshe në kontratën e faktoringut, përkundër ekzistencës së mjetit të faktorit ndaj furnizuesit për mbledhjen e kërkesave të arkëtueshme, shitja dhe/apo transferimi i kërkesave të arkëtueshme konsiderohet të ketë ndodhur dhe të jetë kryer në momentin e nënshkrimit të kontratës së faktoringut.

## **Neni 8**

### **Faktoringu pa Mjet (Garanci)**

1. Faktoringu pa mjet (garanci) është transaksion në të cilin faktori merr përsipër rreziqet e mbledhjes së kërkesave të arkëtueshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në rreziqet që ndërlidhen me paaftësinë e pagesës (insolvencën) së blerësit.
2. Tek faktoringu pa mjet (garanci), furnizuesi nuk është përgjegjës ndaj faktorit për mbledhjen e kërkesave të arkëtueshme nga blerësi.
3. Pavarësisht paragrafëve 1 dhe 2, të këtij neni, furnizuesi është drejtpërdrejt dhe plotësisht përgjegjës ndaj faktorit në lidhje me ekzistencën dhe identifikimin e kërkesave të arkëtueshme që janë objekt i faktoringut pa mjet (garanci), si dhe i garanton faktorit që kërkesat e arkëtueshme nuk kanë kurrfarë barre të asnjë lloji.
4. Nëse kërkesat e arkëtueshme që janë objekt i faktoringut pa mjet (garanci) vërtetohen të kenë ndonjë barrë, të çfarëdo lloji, kontrata e faktoringut konsiderohet si kontratë faktoringu me mjet (garanci), si dhe në këtë rast zbatohet Neni 7 i kësaj Rregulloreje në lidhje me përgjegjësinë e furnizuesit ndaj faktorit.

**Neni 9**  
**Faktoringu i Anasjelltë**

1. Faktoringu i anasjelltë është lloj i posaçëm i faktoringut, ku faktori dhe blerësi negociojnë një plan pagese, si dhe e ekzekutojnë atë në formën e një kontrate detyruese, për pagesën e borxheve të blerësit ndaj furnizuesit(ve) të vet, ku faktori:
  - 1.1 me kërkesë të furnizuesit apo sipas udhëzimit të blerësit, merr përsipër të paguajë pretendimet që furnizuesi(t) kanë ndaj blerësit para maturimit apo në kohën e maturimit të objektit të faktoringut; si dhe
  - 1.2 fiton të drejtën për mbledhjen e kërkesave të arkëtueshme të pagueshme nga blerësi deri në një afat të caktuar të dakorduar ndërmjet blerësit dhe faktorit, si dhe të drejtën e ngarkimit të tarifave dhe kamatës së faktoringut.
2. Në rastet e faktoringut të anasjelltë, pëlqimi i furnizuesit të blerësit është i detyrueshëm.
3. Dispozitat e kësaj Rregulloreje për llojet tjera të faktoringut aplikohen përshtatshmërisht ndaj faktoringut të anasjelltë.

**KAPITULLI III**  
**Kontrata e Faktoringut**

**Neni 10**  
**Forma dhe Fushëveprimi i Kontratës së Faktoringut**

1. Faktoringu mund të ushtrohet vetëm në bazë të kontratës së faktoringut, të lidhur në formë të shkruar.
2. Kontrata e faktoringut duhet të përfshijë në titull emrin e llojit të faktoringut, që është objekt i kontratës përkatëse të faktoringut.
3. Sipas kontratës së faktoringut, faktori merr përsipër detyrimin që të ofrojë faktoringun për furnizuesin, përkatësisht të paguajë faturën e furnizuesit të lëshuar për blerësin, në këmbim të shitjes dhe/apo transferimit tek faktori të kërkesave të arkëtueshme të furnizuesit drejt blerësit si dhe pagesës nga furnizuesi tek faktori të një tarife faktoringu, si dhe të gjitha shpenzimet e faktoringut.
4. Kontrata e faktoringut nuk konsiderohet të jetë kontratë e kredisë sipas ligjeve në fuqi.

**Neni 11**  
**Përmbajtja e Kontratës së Faktoringut**

1. Kontrata e faktoringut duhet të përmbajë së paku informatat vijuese:

- 1.1 informatat bazike të palëve, duke përfshirë por pa u kufizuar në emrat, numrin e regjistrimit dhe/ose identifikimit, adresën e regjistruar dhe informatat mbi përfaqësuesit ligjor/të autorizuar të palëve;
  - 1.2 emri i llojit të faktoringut që është objekt i kontratës së faktoringut;
  - 1.3 informatat bazike për kontratën bazë, që është objekt i kontratës së faktoringut;
  - 1.4 specifikimin e objektit të faktoringut, në përgjithësi, si dhe faturës(ave), duke përfshirë numrin(at) dhe shumën(at), të cilat duhen paguar furnizuesit nga faktori sipas kontratës së faktoringut, në mënyrë të posaçme, si dhe afatin për pagesën e faturës(ave) dhe/ose detyrimeve të tilla;
  - 1.5 specifikimin e tarifës së faktoringut, duke përfshirë edhe mënyrën dhe afatin e pagesës së saj;
  - 1.6 specifikimin e të gjitha shpenzimeve të faktoringut, duke përfshirë edhe mënyrën dhe afatin e pagesës së tyre;
  - 1.7 kohëzgjatjen e kontratës së faktoringut;
  - 1.8 listën e dokumentacionit të bashkangjitur;
  - 1.9 datën e kontratës së faktoringut; dhe
  - 1.10 nënshkrimin e përfaqësuesve ligjorë dhe/ose të autorizuar të palëve.
2. Palët në kontratën e faktoringut mund të shtojnë dispozita të tjera, me kusht që dispozitat e tilla të mos jenë në kundërshtim me këtë Rregullore.
  3. Nëse kontrata e faktoringut nuk përcakton kohëzgjatjen e saj, kontrata e faktoringut mbetet e vlefshme dhe në fuqi deri në datën kur kërkesat e arkëtueshme, të cilat janë objekt i faktoringut, të mblidhen nga faktori.

## **Neni 12**

### **Anulimi dhe Pavlefshmëria e Kontratës së Faktoringut**

Kontrata e faktoringut që për objekt ka shitjen e objektit të një kontrate tjetër faktoringu konsiderohet nule dhe e pavlefshme.

## **Neni 13**

### **Dokumentacioni Përcjellës i Kontratës së Faktoringut**

1. Me lidhjen e kontratës së faktoringut, furnizuesi i siguron faktorit origjinalin apo kopjet e noterizuara të dokumenteve vijuese të lidhura me objektin e faktoringut:
  - 1.1 marrëveshja(et) nga të cilat rrjedhin kërkesat e arkëtueshme të furnizuesit, duke përfshirë por pa u kufizuar në faturën(at) e lëshuara sipas asaj marrëveshjeje në kohën e lidhjes së kontratës së faktoringut; dhe

- 1.2 përveç nëse palët pajtohen ndryshe, njoftimin me shkrim të furnizuesit për blerësin për shitjen dhe/apo transferimin tek faktori të të gjitha kërkesave të arkëtueshme që furnizuesi ka ndaj blerësit.
2. Dokumentacioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet bashkëngjitur marrëveshjes së faktoringut si shtojcë dhe paraqet pjesë përbërëse të saj.
3. Nëse dokumentacioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk i bashkëngjitet marrëveshjes së faktoringut për çfarëdo arsye, duke përfshirë por pa u kufizuar në të qenët i pa-disponueshëm në momentin e lidhjes së kontratës së faktoringut, transferimi i dokumentacionit të tillë nga furnizuesi tek faktori regjistrohet me procesverbal të nënshkruar nga të dyja palët, e i cili i bashkëngjitet kontratës së faktoringut si shtojcë.
4. Data kur faktori pranon nga furnizuesi dokumentacionin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është data kur konsiderohet të ketë ndodhur shitja dhe/apo transferimi i kërkesave të arkëtueshme.

#### **Neni 14**

##### **Njoftimi për Shitjen dhe/apo Transferimin e Kërkesave të Arkëtueshme**

1. Përveç nëse parashihet ndryshe me kontratën e faktoringut ndërmjet palëve, me lidhjen e kontratës së faktoringut, dhe jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga lidhja e kontratës së faktoringut, furnizuesi e njofton me shkrim blerësin për shitjen dhe/apo transferimin e kërkesave të arkëtueshme të cilat rrjedhin nga kontrata bazë tek faktori.
2. Njoftimi për shitjen dhe/apo transferimin e kërkesave të arkëtueshme nga furnizuesi tek faktori mund të jetë i përgjithshëm, duke përfshirë të gjitha kërkesat e arkëtueshme përkatëse që janë objekt i faktoringut, ose specifik, duke përfshirë vetëm kërkesat e arkëtueshme shprehimisht të identifikuar.
3. Nëse njoftimi për shitjen dhe/apo transferimin e kërkesave të arkëtueshme është i përgjithshëm, njoftimi përmban vetëm emrin dhe datën e marrëveshjes nga e cila rrjedhin kërkesat e tilla të arkëtueshme.
4. Nëse njoftimi për shitjen dhe/apo transferimin e kërkesave të arkëtueshme është specifik, përveç emrit dhe datës së kontratës nga e cila rrjedhin kërkesat e arkëtueshme, njoftimi përmban edhe numrin e faturave që identifikojnë kërkesat e arkëtueshme specifike që janë objekt i faktoringut.
5. Njoftimi i përmendur në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, përmban emrin e faktorit dhe detajet e llogarisë bankare të faktorit tek i cili duhen paguar kërkesat e arkëtueshme nga blerësi.
6. Njoftimi i përmendur në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni duhet t'i komunikohet blerësit me shkrim.
7. Detyrimi për njoftim me shkrim, i paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, konsiderohet të jetë përmbushur nëse njoftimi dërgohet nga furnizuesi tek blerësi përmes cilitdo prej këtyre mjeteve të komunikimit:
  - 7.1 posta e rregullt;
  - 7.2 posta rekomandë;

7.3 email;

7.4 telefaksi; apo

7.5 ndonjë mjet tjetër komunikimi të njohur e të paraparë si mjet i pranueshëm komunikimi me shkrim sipas ligjeve në fuqi.

## **Neni 15**

### **Pagesa e Kërkesave të Arkëtueshme**

1. Me pranimin e njoftimit për shitjen dhe/apo transferimin e kërkesave të arkëtueshme, blerësi obligohet të paguajë kërkesat e arkëtueshme tek faktori në llogarinë bankare të specifikuar në njoftim.
2. Kërkesat e arkëtueshme paguhet nga faktori kur ato bëhen të pagueshme sipas kontratës nga e cila rrjedhin ato kërkesa të arkëtueshme.
3. Pagesa e kërkesave të arkëtueshme nga blerësi tek furnizuesi pas pranimin të njoftimit për shitjen dhe/apo transferimin e kërkesave të arkëtueshme nga blerësi nuk e liron blerësin nga detyrimi i tij për të paguar kërkesat e arkëtueshme përkatëse tek faktori.

## **Neni 16**

### **Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve në Kontratën e Faktoringut**

1. Faktori obligohet të mbajë dosje të rregullta e të përditësuara, si dhe obligohet t'i vërë ato dosje në dispozicion të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Faktori obligohet të ushtrojë kujdesin e duhur në regjistrimin e kërkesave të arkëtueshme të blera.
3. Furnizuesi i garanton faktorit që të gjitha kërkesat e arkëtueshme ekzistojnë ligjërisht dhe faktikisht, janë të lira nga pengjet, kontestimet, ngarkesat dhe të drejtat tjera të palëve të treta, si dhe që ato kërkesa të arkëtueshme nuk mund të kontestohen në asnjë bazë, përveç nëse dakordohen ndryshe.
4. Nëse kërkesat e arkëtueshme të shitura janë nën peng apo nëse kërkesat e tilla të arkëtueshme janë kontestuar në çfarëdo mënyre nga një blerës apo palë e tretë, si dhe kur marrëveshja e faktoringut nuk përjashton shprehimisht përgjegjësinë e furnizuesit ndaj faktorit, faktori gëzon të drejtën e mjetit ndaj furnizuesit edhe nëse është lidhur kontrata e faktoringut pa mjet (garanci).
5. Nëse shitja dhe/apo transferimi i kërkesave të arkëtueshme është e ndaluar sipas kontratës bazë ndërmjet furnizuesit dhe blerësit, ndalesa e tillë nuk ka efekt juridik mbi shitjen dhe/apo transferimin e kërkesave të arkëtueshme tek faktori nga furnizuesi sipas kësaj Rregulloreje.
6. Dokumentet e përmendura në nenin 13, paragrafi 1, të kësaj Rregulloreje konsiderohen dokumente të besueshme për qëllimet e përmbarimit, në pajtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore.



## **KAPITULLI IV**

### **Raportimi dhe Mbikëqyrja e Veprimtarisë së Faktoringut**

#### **Neni 17**

##### **Kriteret e Përgjithshme**

1. Faktoringu, si veprimtari financiare, mund të ushtrohet vetëm nga subjektet juridike që licencohen/regjistrohen nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për t'u marrë me faktoring.
2. Faktoringu, si veprimtari financiare, mund të ushtrohet ose nga bankat dhe/ose institucionet financiare jo-bankare të licencuara/regjistruara, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Subjektet juridike që synojnë të merren me faktoring duhet të themelohen/organizohen vetëm si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare.
4. Subjektet juridike që merren vetëm me ushtrimin e veprimtarisë financiare të faktoringut duhet të përfshijnë në emrat e tyre termin "faktoring" dhe /apo "faktor."
5. Procedurat për regjistrimin, licencimin/regjistrimit, mbikëqyrjen, raportimin dhe revokimin e licencave/regjistrimeve të subjekteve që merren me faktoring rregullohen me ligjet dhe aktet nënligjore që zbatohen për subjektet përkatëse juridike që mbajnë licencë/regjistrim faktoringu.

#### **Neni 18**

##### **Licencimi / Regjistrimi dhe Mbikëqyrja e Subjekteve Juridike të Angazhuara në Faktoring**

1. Kriteret e licencimit/regjistrimit dhe kërkesat e kapitalit për institucionet financiare jobankare të angazhuara në faktoring janë të përcaktuara në Rregulloren për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Aktivitetet e Institucioneve Financiare Jobankare. Në rast se faktoringu ofrohet nga bankat, zbatohet korniza ligjore për licencimin e bankave.
2. Bankat e angazhuara në veprimtari të faktoringut duhet të raportojnë në pajtim me Rregulloren për Raportimin nga Bankat. Institucionet financiare jobankare të angazhuara në veprimtari të faktoringut duhet të raportojnë në pajtim me Rregulloren për Raportimin nga Institucionet Financiare Jobankare.
3. Menaxhimi i rrezikut për faktoring, duke përfshirë klasifikimet dhe provizionimet e mundshme për këtë veprimtari, do të përcaktohet me rregullore të veçantë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

#### **Neni 19**

##### **Veprimtaritë Tjera të Lejuara për Subjektet Juridike të Licencuara/Regjistruara për Faktoring**

1. Subjektet juridike të licencuara/regjistruara për faktoring nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mund të angazhohen edhe në veprimtaritë vijuese të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e faktoringut si veprimtari financiare:

- 1.1 mbledhja, prodhimi, analizimi dhe dhënia e informatave për mundësitë hua-marrëse të subjekteve juridike dhe personave fizikë të organizuar si shoqëri tregtare;
  - 1.2 menaxhimi i kërkesave të arkëtueshme të klientit që lindin në bazë të mallrave të shitura dhe shërbimeve të ofruara si dhe konsultimet në lidhje me këto;
  - 1.3 mbledhja e kërkesave të arkëtueshme;
  - 1.4 financimi i eksportit në bazë të blerjes me zbritje dhe pa mjet të pretendimeve afatgjate, ende të pa-pagueshme, mbi instrumentet e siguruara financiare (forfeiting); dhe
  - 1.5 lëshimi i mbulesës kreditore në rastin e ushtrimit të faktoringut të huaj.
2. Subjektet e licencuara për faktoring nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nuk mund të angazhohen në veprimtaritë vijuese:
- 2.1 blerja e kredive të këqija, të përkufizuara si të tilla sipas ligjeve në fuqi; dhe
  - 2.2 blerja e riskut apo beneficionit në bazë të portofolit të kredive jo-performuese të institucioneve kreditore, risk apo beneficion i definuar si i tillë sipas ligjeve në fuqi.

## **Neni 20**

### **Dispozitat Përfundimtare dhe Kalimtare**

Të gjitha kontratat e faktoringut që janë lidhur para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, vazhdojnë të rregullohen nga ligji i zbatueshëm për faktoring dhe/apo ligji i përcaktuar në ato kontrata që ishte në fuqi para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, përveç nëse palët në ato kontrata shprehimisht pajtohen të rregullojnë marrëdhëniet e tyre me këtë Rregullore.

## **Neni 21**

### **Zbatimi, Masat Përmirësuese dhe Dënimet Civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve civile, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

## **Neni 22**

### **Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj nga Bordi i Bankës Qendrore.

---

Flamur Mrasori,  
Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore